



Mirjam Laçi



## FËMIJET E DALLASIT ZGJEROJNE DIAPOZONIN KULTUROR NE GJUHEN SHQIPE

Kujdesi i vazhdueshëm i shqiptarëve të Dallasit për zhvillimin e gjuhës kombëtare dhe për zbatimin e normave të saj ka marrë një hov të ri sidomas në gjysmën e dytë të vitit '96. Shtresa gjithnjë e më të gjera fëmijësh shqiptar po interesohen gjallërisht që ta mësojnë mirë, drejt e pa gabime gjuhën e sotme letrare. Zotërimi dhe zbatimi i rregullave të

kualifikuar për vendin e kësaj pune të rëndësishme dhe delikate etj. Dhe kjo nuk u arrit lehtë. Ministria e arsimit të Kosovës, këshilli i arsimtarëve shqiptarë të Nju Jorkut dhe kryesia e shoqatës "Iliria" u detyruan t'i përveshen një pune serioze për të shijuar kënaqësinë me të cilën flasin dhe shkruajnë shqipen letrare fëmijet e shqiptarëve të



drejtshkrimi është, natyrisht, detyra e parë në këtë fushë. Por norma letrare kombëtare, siç dihet, është më e gjerë se drejtshkrimi. Gjuha letrare është një tërësi e përbërë: ajo ka sistemin e saj fonetik e gramatikor, strukturën leksikore e fjalëformuese dhe stilet e saj funksionale. Te të gjitha këto veprojnë ligje e rregulla të caktuara, prandaj për ta folur e shkruar drejt gjuhën letrare duhet të njihen e të zbatohen drejt edhe këto ligje e rregulla, të cilat janë të pamundura për fëmijët t'i marrin vetëm duke u bazuar në njohuritë që ekzitojnë në bagazhin gjuhësor të prindërve të tyre.

Megjithëse kjo shkollë ka në gjirin e saj vetëm 18 nxënës, për vite të tëra, nuk mundi të arrihej mësimdhënia e tyre në mënyrë të rregullt e pa shkëputje. U desh një mobilizim unik i të gjithë shqiptarëve për të kapërcyer me sukses pengesat serioze, si: gjetjen e lokalit dhe financimin e tij, furnizimin e nxënësve me tekstet e duhura, gjetjen e një arsimtari apo arsimtarje të

Dallasit.

Megjithatë komisjonet hartuese të këtij sistemi shkollor janë të vetëdijshëm se në këto rrethana, ky program pedagogjik, nuk përfshinë as të gjitha fushat, as të gjitha çështjet që kanë nevojë të ndriçohen nga këndi i vështrimit të normës gjuhësore kombëtare. Një trajtim të veçantë do të kërkonin sidomas çështjet e normës leksikore - përdorimi i drejtë i fjalëve e i kuptimeve të tyre, lufta kundër fjalëve të anglishtes që instinktivisht futen tek nxënësit dhe prishin pastërtinë e qartësinë e gjuhës sonë letrare, disa çështje të stilistikës leksikore etj. Siç dihet, për përballimin e këtyre problemeve do të duheshin tekste të hartuara me leksione specifike nga ku nxënësit do të merrnin armët e nevojshme për të luftuar këto vështirsi. Vetëm tre orë mësim në javë, në këto kushte, janë vetëm vrapim pas ëndërrës për të mësuar shqipën këta vogëlushë, por kurrsesi kapje e plotë e kësaj ëndërrë të bukur.


## MBRËMJE SHQIPTARE NË TEKSAS

(MBRESA)

U bënë javë që nga mbrëmja e 28 Nentorit, por nga dita në ditë diçka më ngacmon brenda vetes për të hellë në leter ca mbresa nga ajo natë e struktur hedhur në gjirin e vjeshtës që shkoj Ajo që më tepër se një mbrëmje festive. Ajo që një mbrëmje festive shqiptare. Shqiptarët e Teksasit i dhanë asaj një fytyrë të re, një kuptim të ri e një jehonë që akoma e ruan ëmbëlsinë në sytë e qeshur të tyre. Edhe në qofsh i huaj nuk është aspak e vështirë ta kuptosh se krenaria kombëtare përbën një pjesë të mirë të kimistrisë së popullit tonë. Ai gjak që lau malet dhe fushat e Shqipërisë, Grudës dhe Kosovës dhe ato duar që ngritën flamurin shqiptar me 28 nentor 1912 nuk i përkasin një dite të largët. Po të vëresh me vemendje dhe të futesh thellë në kuptimin e syve të secilit pjesëmarrës në këtë natë aty do të shpalosen flamuj lirie, do të hapen fushëbeteja të ashpëra, aty do të shpërthejë liri. Secili duket nga pak Ismail Qemal...

Salla e hotelit çdo minut sa vjen e bëhet më shqiptare. Përsëritet, dhënie duarsh, përqaftime e biseda të ngrohta në çdo cep të sallës së madhe dhe koridoreve Flamuri shqiptar i mbërthyer në mur si një flutur e rrallë që duket se së bashku me pranverën kombëtare ka sjellur edhe harmoninë individuale të njerëzve. Megjithëse bermdan një ore u mblodhen më se 450 shqiptarë, të gjithë ngajmë dhe ndjehemi si bijet e një nënë.

Ju, lexues të dashur, ndoshta nuk keni degjuar më parë për heronjtë e vegjël shqiptarë: Shqiponja Halili, Asdren Azemi, Donika Salju, Igli Laçi, Albana e Lela Lulla, Dielli Salju, Flora Ceka, Lindsey Memeti, Adelina Hidi, Madie Kaba, Flamur e Alban Halili, Fatime Salju, Hartim Hoxha, Milihat Ferra, Sajmir Abdullahi, Burim e Bujar Hajro, Minator Azemi, Kosovare Halili e Arta Demaliaj. Sidoqoftë për këtë sa unë as ju nuk jemi të fajshëm. Ne kemi midis nesh më shumë heronj që nuk i njohim, se sa heronjë që dimë diçka për heroizmin e tyre. Disa janë heronj të një lufte, disa heronjë të një punë, ca të tjerë heronj të një momenti e disa, si këta që sapo citova që, jo unë, por publiku prej më se 450 vetash të asaj nate i vlersojë heronj të atij mbasmuzgu me duartrokijet e gjata



Gjeke Marinaj

e me një kombinacion gjysma lotë kënaqësie e lotë malli e dhembje, gjysma tjetër në fytyrë. Pra qene recitimet e ketyre vogëlushëve të moshave të ndryshme që elektrizuan sallen me surprisën e një montazhi poetik të zgjedhur e regjizuar me ndjenjë atdhedashurie nga mësuesja e tyre e gjuhës shqipe zonja, Miriam Laçi.

Menjëherë mbas largimit të buqetes fëmijërore nga skena, për një moment, u duk se këndi kohor që qe caktuar për fëmijët ishte një gabim teknik i orgonizuesve Harun Ceka e Nazar Mehmeti. Ndoshta ëmbëlsira e natës, e ndoshta e viteve, të shqiptarëve të Dallasit duhej lënë për në fund të mbrëmjes. Kjo mund e ftohte disi rëndësinë e fjalimit të kryetarit të shoqatës z. Zenun Halili. Ndoshta u duhej ca kohë shqiptarëve të çliroheshin nga emocionet që u ngjallën fëmijët me zërin poetik të tyre. Por jo. Zenuni e filloj fjalimin dhe heshtja e pushtoj sallën. Ai e kishte përgatitur fjalimin e tij në mënyrë aq të mprehtë e me aq

pkjuri intelektuale duke prekur e analizuar çështjen kombëtare pa harruar ta gërshetojë mirë me rëndësinë e festës së flamurit, sa ndjenjat e njerëzve zunë të bymehen përsëri. Të gjithë tashmë e kuptuan se s'kanë të bëjnë me një festë të zakonshme, por me një formë festimi krejtësisht të jashtëzakonshëm.

Bukuria festive zë të veshet edhe me një cilesi të re. "MËMËDHEU", ky është emri i grupit artistik që me në fund, sinjalizon se intervali i darkës nuk është aspak në rënie të paqës shpirtërore. Ky grup muzikantësh i përbërë nga Selvie Mehmeti, Ismail Mehmeti, Shpend Jonuzi, Abdyl Mehmeti e Zia Sulo, ua bënë shqiptarëve Atdheun pothuajse të prekshëm me talentin e jorëndomtë të tyre. Këngët e tyre shoqerohen me valle nga publiku. Mbushet sheshi i vallëzimit. Personeli i shërbimit të hotelit mahnitet me koreografinë e zgjedhur për vallet. Janë vertet momente të papërsëritëshme kënaqësie. Nuk di ku t'i hedhësh sytë më parë; tek Ekrem Bardhi, Nashiri, e Deda në një rënë anë të valles apo tek Hajdar Zoga me gruan dhe vajzat në anën tjetër.

"Këtë vit kemi ndryshime edhe në numrin shqiptarëve pjesëmarrës në festën e flamurit", thotë Nazar Mehmeti. Ai mendon se do të jetë e mundur që të mblidhen rreth një mijë dollarësh për të ndihmuar ecurinë e klubit të shoqatës "Iliria".

Pa dyshim imazhi i kësaj feste do të jetoje gjatë në mendjet e shqiptarëve të Dallasit, jo si një ëndërr e brishtë, po si një horizont i ndriçuar në ecurinë e aktiviteteve kombëtare e familjare.

